

**Projekte rrjedhëse të financuara nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim  
janar 2022**

<b>Emri i projektit</b>	<b>Qëllimi i projektit</b>	<b>Vlera e huasë (milione euro)</b>	<b>Viti i fillimit të projektit</b>
Projekt për përmirësimin e linjës hekurudhore të Korridorit X	Qëllimi i këtij projekti është rindërtimi i disa pjesëve të linjës hekurudhore të Korridorit X në pjesën Tabanovc – Kumanovë, Miravcë – Smokvicë, Nogaevcë – Gradsko – Kukuriçanë dhe Krivolak – Negotinë, me ç'rast do të ulen shpenzimet për mirëmbajtjen e saj dhe do të sigurohet qarkullim i sigurt në këto pjesë.	176	2010
Rihabilitimi i pjesës lindore të linjës hekurudhore të Korridorit VIII, faza 1 – pjesa Kumanovë – Beljakovcë	Me rihabilitimin e kësaj pjese, do të kontribuohet në zvogëlimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e saj dhe do të sigurohet qarkullim i sigurt, përkatësisht do të përmirësohet siguria gjatë qarkullimit të njëjzve dhe të mirave, do të kursehet kohë dhe do të ketë përfitime ekologjike.	464	2012
Përmirësimi i sistemit të navigacionit ajror në Maqedoni – faza e dytë - pa siguruar garanci shtetërore	Me këtë projekt do të modernizohet pajisja që shfrytëzohet për kontrollimin e fluturimeve, përkatësisht parashihet që të përmirësohen performancat e sistemit të përgjithshëm (siguria, kapaciteti, efikasiteti i shpenzimeve, efikasiteti, fleksibiliteti, parashikueshmëria, ndikimi mbi mjedisin etj.).	11.15	2013
Rivitalizimi dhe modernizimi i rrjetit përçues dhe menaxhimi i sistemit enektoenergjetik – pa siguruar garanci shtetërore	Me implementimin e këtij projekti do të rritet cilësia e furnizimit me energji elektrike, siguria në furnizimin me energji elektrike të shfrytëzuesve nga sistemi i përçimit, si dhe do të kryhet rivitalizimi i largpërçuesve 110 kV që janë më të vjetër mbi 40 vite.	25	2013
Rihabilitimi i pjesës lindore të linjës hekurudhore të Korridorit VIII, faza 2 – pjesa Beljakovcë – Kriva Pallankë	Ky projekt parashikon ndërtimin e linjës hekurudhore të Korridorit VIII të pjesës Beljakovcë – Kriva Pallankë, duke përfshirë edhe rikonstruimin e pjesëve ekzistuese të linjës, në gjatësi totale prej 34 km.	145	2014
Programi për rrugë nacionale	Qëllimi i këtij programi është që të përmirësohet cilësia e infrastrukturës rrugore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Realizimi i këtij Projekti do të financohet përmes huasë së lartpërmendur në dy transe. Me transhin e parë do të financohet ndërtimi i pjesës rrugore Raec – unaza Drenovë në nivel të rrugës ekspres dhe rikonstruimi i pjesës rrugore Shtip – Koçan në nivel të rrugës ekspres - zgjidhje gjysmë autostrade.	181	2014
Ndërtimi i largpërçuesit interkonetiv 400kV TC Manastir 2 (Republika e Maqedonisë) – TC Elbasan (Republika e Shqipërisë) – pa siguruar garanci shtetërore	Me realizimin e këtij projekti do të ndërtohet trafostacion i ri 400/110 kV në Ohër në gjatësi prej 90 km dhe një pjesë e largpërçuesit nga Manastiri deri në kufirin me Republikën e Shqipërisë. Me këtë projekt për herë të parë do të lidhen sistemet elektroenergjetike të Maqedonisë dhe Shqipërisë.	37	2015

Ndërtimi i pjesës rrugore Shtip – Radovish	Ky projekt është pjesë e politikës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës rrugore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me realizimin e këtij projekti, do të lehtësohet qarkullimi i njerëzve, të mirave dhe shërbimeve në pjesën juglindore të vendit.	64	2015
Ndërtimi i pjesës rrugore Kriva Pallankë – Deve Bair (kufiri me Bullgarinë)	Ky projekt përfshin rehabilitimin dhe zgjerimin në përgjithësi të pjesës rrugore Kriva Pallankë – Deve Bair në gjatësi të përgjithshme prej 13 km. Kjo seksion rrugore është pjesë e Korridorit paneuropian të komunikacionit VIII dhe për shkak të kësaj përfitimet nga realizimi i këtij projekti janë me interes si nacional ashtu edhe rajonal.	10	2018
Ndërtimi dhe instalimi i sistemit elektronik për pagesën e taksës rrugore përgjatë Korridorit VIII dhe autostradës Miladinovcë – Shtip	Me këtë projekt parashihet ndërtimi dhe modernizimi i pikave ekzistuese të pagesës së taksës rrugore përgjatë Korridorit VIII, si dhe ndërtimi i tri stacioneve të reja të pagesës së taksës rrugore në autostradat që ndërtohen në Republikën e Maqedonisë së Veriut, instalimi i pajisjes, mirëmbajtja dhe pjesë të detyrueshme rezervë për pikat e pagesës.	13	2019
Projekt për prokurim me autobusë të rinj për Qytetin e Shkupit	Projekti përfshin prokurimin me autobusë të rinj për Qytetin e Shkupit, konkretisht prokurim me autobusë me dysheme të ulët të cilët punojnë me gaz natyror të kompresuar me efikasitet të madh ekonomik dhe përparësi ekologjike sa i përket karakteristikave të autobusëve ekzistues.	10	2019
Stacioni për pastrimin e ujërave të zeza në Shkup	Qëllimi i Projektit është trajtimi i ujërave të zeza të mbledhur në Qytetin e Shkupit dhe në zonat përreth në përputhje me standardet e prezantuara në Direktivën 91/271/KEE për trajtim të ujërave të zeza urbane.	58	2019
Projekti “Vendosja e transportit të shpejtë me autobus në Qytetin e Shkupit”	Qëllimi kryesor i Projektit është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të transportit të udhëtarëve “lindje – qendër – perëndim” dhe “jug – qendër – veri”, zvogëlimi i kohëzgjatjes së transportit të udhëtarëve, si dhe qasja më e mirë dhe shfrytëzimi i shërbimeve të transportit nga personat me invaliditet dhe njerëzit me aftësi të kufizuara.	70	2021
Korridorit rrugor VIII – faza I e projektit (pjesa Bukojčan – Kërçovë)	Realizimi i këtij projekti do të kontribuojë në ndërtimin e një pjese të Korridorit rrugor europian 8, që është korridor shumë i rëndësishëm rajonal dhe i cili në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është në gjatësi prej 305 km, nga kufiri me Republikën e Bullgarisë (V.K. Deve Bair) përmes Kriva Pallankë – Kumanovë – Miladinovcë – Shkup – Tetovë – Gostivar – Kërçovë – Trebenishtë – Strugës – kufiri me Republikën e Shqipërisë (V.K. Qafë Thanë) dhe pjesa nga Podmolje deri në Ohër paraqet lidhja shumë e rëndësishme Lindje – Perëndim, që gjithashtu mundëson që të lidhet limani Burgas me limanin e Durrësit në Shqipëri dhe më tej me limanin Brindizi në Republikën e Italisë (deti Adriatik).	110	2021